



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E INTEGRITETIT, MBIKËQYRJES DHE ANKESAVE ADMINISTRATIVE E
GJYQËSORE

Lënda: Kthim përgjigje tuajës të datës 19.03.2022

Z. POLIKRON HORESHKA

Tiranë

Për dijeni: MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT

Tiranë

Pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP) është administruar shkresa juaj e datës 19.03.2022, protokolluar me tonën nr. 1964 prot., datë 23.03.2022, përmes së cilës kërkoni informacion nga ana e Departamentit të Administratës Publike, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Lidhur me kërkesën tuaj ju informojmë se:

Së pari, për sa i përket pyetjeve tuaja në lidhje me fillimin e ecurisë disiplinore për nëpunësit civilë, z. R. B., në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve dhe znj. L. K., në pozicionin Përgjegjëse e Sektorit të Përgatitjes së Fizibilitetit të Projekteve për Pastrimin e Mjedisit dhe Trajtimin e Mbetjeve, nga verifikimet e kryera pranë Departamentit të Administratës Publike, nuk rezulton që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të ketë filluar ecurinë disiplinore për nëpunësit e mësipërm.

Pika 4 e nenit 59 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, parashikon se :

“4. Komisioni disiplinor fillon procedimin: a) me kërkesë të eprorit direkt të nëpunësit civil; b) me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil; c) me nismën e çdo anëtari të komisionit, bazuar në fakte konkrete të provueshme për kryerjen e një shkeljeje disiplinore.”

Për sa më sipër, që të kërkohet fillimi i procedimit disiplinor për rastet e lartpërmendura, është e domosdoshme prania e provave dhe fakteve, që të tregojnë në mënyrë të qartë kryerjen e një prej shkeljeve disiplinore konkrete të parashikuara nga neni 57 i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe shkallën e fajësisë, shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj, të parashikuar në vijim në nenin 59 të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar.

Eprori direkt i nëpunësve civilë, z. R.B. dhe znj. L.K., në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, do duhet të kryejë verifikime të thelluara bazuar në pretendimet e paraqitura në e-mailin e depozituar nga ana juaj dhe mbas shqyrtimit të fakteve, të vlerësojë nëse jemi përpara fillimit të një ecurie disiplinore për këta nëpunës, bazuar në dispozitat përkatëse të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Së dyti, për sa i përket pyetjeve tuaja në lidhje me znj. L.K., Departamenti i Administratës Publike nuk është vënë në dijeni për një vendim gjyqësor të formës së prerë ndaj këtij nëpunësi civil, me qëllim që njësia e burimeve njerëzore pranë institucionit ku ajo ushtron detyrën, të zbatojë institutin e përfundimit të marrëdhënies në shërbim civil, sipas nenit 65, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Së treti, për sa i përket kërkesës tuaj në lidhje me ankimin që keni kryer për vlerësimin e rezultateve në punë jokënaqshëm (4), për 6 mujorin e dytë të vitit 2021, ju bëjmë me dije se bazuar në nenin 41, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, si dhe kreun V, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, e ndryshuar, zyrtari autorizues brenda 5 (pesë) ditëve, shqyrton ankimin dhe bën vlerësimin përkatës, i cili shënohet dhe nënshkruhet nga ky i fundit në formularin e vlerësimit të rezultateve në punë.

Në lidhje me pretendimin tuaj për mosshqyrtimin e ankimit të vlerësimit të rezultateve në punë, ju keni të drejtë t’i drejtoheni gjykatës kompetente, e cila ka tagrin ligjor të shqyrtojë procedurën e ndjekur, sipas dispozitave ligjore përkatëse.

Faleminderit për mirëkuptimin.